

Ditari Naturës



Nr. 48 Viti i pestë i botimit Maj 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Çfarë u konstatua nga investigimi i zbatimit të liqshmërisë në dy parqe kombëtare në kuadër të perceptimit të shoqërisë civile? *Nga Nihat Dragoti*
- STOP Urbanizimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta
- OMSHC-të shqiptare për promovimin e mbrojtjes së natyrës
- Shkencëtarët e gjeneratës tjetër
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se
9 vjet më parë ...

... me VKM nr. 640, datë 21.05.2008, ekosistemi natyror malor Shebenik-Jabllanicë shpallet "Park Kombëtar", me një sipërfaqe të përgjithshme prej 33,927.7 ha. PK shtrihet

kryesisht në bashkitë e Librazhit dhe në atë të Bulqizës.

Për këtë Park Kombëtar është zhvilluar dhe projekti "Mbështetje institucionale për MMPAU për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit në zonat e mbrojtura dhe menaxhimin e mbetjeve", që u *Vijon në faqe 2*



Parqet Kombëtar Shebenik-Jabllanicë © Foto INCA



Institute for Nature Conservation in Albania
Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Vijon nga faqe 1 financua nga Qeveria Italiane dhe u zbatua nga IUCN.

Projekti synonte forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e zonave të mbrojtura nëpërmjet zbatimit të protokolleve e përfaqësive planifikuese me bazë ekosistemin dhe pjesëmarrjen. Projekti përmbante një komponent për përgatitjen e planit të menaxhimit për Parkun Kombëtar Shebenik Jabllanicë, i cili ka përfunduar. Plani i menaxhimit synon të rrisë efektivitetin e ruajtjes së biodiversitetit brenda parkut si dhe nxitjen e rolit të saj thelbësor në zhvillimin e komuniteteve që jetojnë brenda apo pranë këtyre ekosistemeve të rëndësishme (pa harruar edhe kontekstin ndërkuftar). Plani i menaxhimit prek të gjitha aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm (sociale, institucionale, ekonomike dhe mjedisore) në një mënyrë të integruar me qëllimin final nxitjen e ruajtjes së biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe mbështetjen e zhvillimit harmonik socio-ekonomik...

...2 vjet më parë ...

...me urdhërin nr.1792, datë 09.05.2015 miratohet Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar "Prespa"...

...5 vjet më parë ...

...miratohet Ligji Nr. 64, dt 31.05.2012 "PËR PESHKIMIN"

Ky ligj rregullon veprimtarinë e peshkimit në tërësi, menaxhimin e tij, siguron mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm në aktivitetin në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, rregullon marrëdhëniet që lindin dhe lidhen me siguri në ushqimore të produkteve të peshkimit, mbrojtjen e konsumatorit dhe sëmundjet e peshqve, të cilat rregullohen me ligje të veçanta.

Ky ligj ka për qëllim:

- sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përqejgjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe atyre detare;

- përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve përkatëse në proceset e vendimmarrjes;
- përcaktimin e masave të ruajtjes, që garantojnë mbrojtjen e burimeve biologjike detare dhe ujërave të brendshme;
- nxitjen dhe përkrahjen e kërkimit shkencor e teknologjik dhe grumbullimit të të dhënave në peshkim;
- sigurimin e funksionimit dhe menaxhimit të porteve e të qendrave të peshkimit;
- hartimin dhe sigurimin e një politike strukturore, me qëllim ristrukturimin e sektorit të peshkimit, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, forcimin e konkurrencës e zhvillimit ekonomikisht të vlefshëm të subjekteve të peshkimit, rigjallërimin e zonave që varen nga peshkimi, si dhe përmirësimin e furnizimit të tregut dhe rritjen e vlerës së prodhimit;
- përcaktimin e masave dhe rregullave të nevojshme për kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit, në përputhje të plotë me politikat evropiane në këtë drejtim;
- ngritjen e një sistemi kontrolli për peshkimin dhe vendosjen e procedurave të inspektimit të standardizuara dhe të koordinuara si në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e treg.

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për krenmtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

INCA është e gatshme që të ndihmojë për promovimin e vlerave të natyrës e të biodiversitetit, në ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe në hartimin e historisë së zonave të mbrojtura të Shqipërisë.

Ç'farë u konstatua nga investigimi i zbatimit të ligjshmërisë në dy parqe kombëtare në kuadër të perceptimit të shoqërisë civile ?

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), së bashku me disa OMSHC, në kuadër të projektit “Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMShC) Shqiptare për promovimin ruajtjes së natyrës në Shqipëri”, i mbështetur nga Bashkimi Evropian (Delegacioni në Shqipëri) dhe i zbatuar nga REC-Shqipëri, ka monitoruar gjendjen dhe menaxhimin në parqet kombëtare “Lugina e Valbonës” dhe “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”.

Për monitorin e problematikës së ruajtjes, menaxhimit dhe përdorimit të burimeve natyrore, u përzgjedhën nga 5 OJF lokale në të dy qarqet. Me këto shoqata zhvilluam trajnime mbi njohjen e legjislacionit për fushën e ruajtjes së natyrës, mënyrat e investigimit në terren dhe plotësimin e një pyetësori/investigues, të parapërgatitur.

Nga pikëpamja ligjore dhe institucionale vihet re se ka përpjekje dhe arritje drejt standardeve evropiane, por problem mbetet forcimi i zbatimit të ligjit në fuqi dhe i kompetencave përkatëse si të AdRZM-ve ashtu edhe të Bashkive. Menaxhimi i këtyre PK ende nuk është në standartet e kërkuara, megjithë përpjekjet që po bëhen pas krijimit të AKZM.

Situata aktuale ende nuk reflektohet në realitet në mënyrën si ato ruhen dhe menaxhohen; kjo është e lidhur edhe me stafin e angazhuar për këtë çështje. Investigimi i kryer dhe një shikim të përgjithshëm situatës në dy parqet pilote, u vu re lehtësisht se ndërhyrjet njerëzore, kanë ndikuar në prishjen e baraspeshës ekologjike të natyrës, si rrjedhojë edhe e mos njohjes së statusit përkatës të PK.

Mosnjohja sa duhet, zbatimi i dobët i legjislacionit dhe menaxhimi joefektiv i aplikuar në praktikë, vazhdojnë të mbeten shqetësimet kryesore të ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit në Shqipëri. Investigimi i kryer në këto dy parqe nxorri në pah se, megjithëse janë hartuar planet e menaxhimit, ato nuk disponohen nga administratat përkatëse të të dy qarqeve. Njëherazi plani i menaxhimit për PK “Lugina e Valbonës” ende nuk është miratuar nga Ministria e Mjedisit. Ndërsa për PK “Bredhi i Hotovës-Dangëlli” është miratuar, por si rrjedhojë e mos pasjes së tij, nuk po gjen zbatim

nga administrata **nga Nihat Dragoti** përkatëse.

Veç kësaj për PK “Lugina e Valbonës” ende nuk është krijuar Komiteti i Menaxhimit, sipas VKM nr. 86, datë 11.02.2005 “Për krijimin e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura”; ndërsa për PK “Bredhi i Hotovës-Dangëlli” ky komitet është ngritur dhe ka funksionuar vetëm për periudhën e zbatimit të projektit “SELEA” (2012), në këto vite të fundit ky komitet nuk është mbledhur asnjëherë.

Në këto dy parqe burimet natyrore janë nën kërcënim e presion të vazhdueshme si: prerjet e paligjshme të pyjeve, gjuetia, mbi peshkimi; erozioni, degradimi i tokës, zjarret; keq menaxhimi i ujërave; turizmi i pakontrolluar dhe aktivitetet rekreative jo mirë të menaxhuara; ndotja e mjedisit, mostrajtimi i ujërave të zeza dhe të përdorura; menaxhimi i pa kontrolluar i territorit, ndërtimet kaotike dhe infrastruktura; vëmendja e pakët ndaj peizazhit; mungesa e menaxhimit të integruar dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe e alternativave për zëvendësimin e tyre, etj. Shqetësim mbetet ndotja e mjedisit, e derdhjes së ujërave të zeza, të hedhjes së inerteve apo dhe të mbeturinave, të cilat i gjen kudo, sidomos në lugina, përrenj, lumenj si dhe pranë qendrave dhe shërbimeve turistike, kur vërehet një fluks në rritje të vizitorëve vendas dhe të huaj. Strukturat përgjegjëse shtetërore nuk kanë plane për grumbullimin dhe largimin e këtyre mbeturinave apo dhe të ndërtimit të vendeve të posaçme për trajtimin e tyre.

Ndërtimi i HEC-ve, në të dy PK, ka qenë dhe është lakuar vazhdimisht, por gjendja nuk ka ndryshuar. Ndalimi i ndërtimit të tyre, duke patur në konsideratë aktet ligjore në fuqi, statusin e tyre dhe kërkesat e vazhdueshme të OMSHC-ve vendase, por dhe ndërkombëtare, përfshi dhe Parlamentin Evropian, për ndalimin e ndërtimit të HEC-ve, brenda territorit të qarqeve kombëtare, nuk po ndodh. Sitata më e rëndë paraqitet në PK “Lugina e Valbonës”, ku parashikohet të ndërtohen edhe 10 HEC të tjerë. Gjatë investigimit u ndeshëm edhe me fillimin e ndërtimit të HEC Dragobia.

Problematike mbetet mungesa e *Vijon në faqe 4*

Vijon nga faqe 3 hartimit të planeve të mbarështrimit dhe të inventarizimit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET), bazuar në dispozitat ligjore përkatëse. Ministria e Mjedisit nuk ka miratuar një listë që ndalon mbledhjen e BMET të rralla, të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje; zonat, ku çdo fillim viti do të vilen dhe mblidhen BMET, afatet dhe kalendarin e vjeljes për secilin lloj si dhe llojet që do të vilen, mblidhen apo do të grumbullohen etj, bazuar në kërkesat e ligjit. E njëjta situatë është dhe për menaxhimin dhe përdorimin e kullotave dhe të livadheve, për të cilat ka mungesë të të dhënave nga strukturat përgjegjëse të bashkive. Nuk u vërejtën raste të ndërtimit të guroreve e të minierave; por nga ana tjetër nuk u paraqiten të dhëna për dëmet dhe llojshmërinë e tyre në lidhje me pyjet, kullotat, peshkimin, bimët mjekësore e prodhimet e dyta, zënie të territorit, ndërtime të çfarëdo lloji, etj.

Moratoriumet e ndërmarra nga qeveria janë iniciativa të rëndësishme edhe pse përfaqësojnë zgjidhje të përkohshme, por kërkohet më shumë ndërgjegjësim dhe bashkëpunim, nëpërmjet shoqërisë civile, për të arritur rezultate të dukshme dhe afatgjata. Në këtë drejtim vërehet se veç disa specialistëve të fushës dhe të gjuetarëve, mjaft përdorues të burimeve natyrore nuk kanë dijeni për këto moratoriume. Institucionet përgjegjëse nuk disponojnë të dhëna se si janë zbatuar moratoriumet, apo rastet e prerjes dhe të gjuetisë së paligjshme. Nga kontaktet me banorët pohohen rastet e prerjes dhe të transportit të lëndës drusore dhe të gjuetisë. Strukturat përgjegjëse të bashkive nuk i kanë të qarta detyrat, përgjegjësit dhe kompetencat që u janë transferuar tashmë, për menaxhimin e fondit pyjor shtetëror dhe sigurimin e furnizimit të banorëve me drutë e zjarrit. Krahas kësaj, strukturat menaxhuese të bashkive të reja dhe aktorët të tjerë lokal, shpesh nuk kanë njohuritë, aftësitë dhe infrastrukturën e nevojshme për të arritur një menaxhim efektiv të Parqeve Kombëtare dhe të burimeve natyrore.

Përfshirja e komuniteteve lokale, në ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e PK, ende nuk është në rrugën e duhur. Komunitetet lokale, në shumicën e rasteve, nuk arrijnë të prekin përfitimet socio-ekonomike që rrjedhin nga menaxhimi i

qëndrueshëm i burimeve natyrore në parqe. Kjo situatë vjen si rrjedhojë e kapaciteteve të ulëta, e mungesës së njohurive në grupet e komunitetit lokal dhe të moskoordinimit midis organizatave të shoqërisë civile që i përfaqësojnë. Aktualisht pengon zbatimin efektiv të politikave të ruajtjes së mjedisit, lehtësisht çon në konflikte dhe keqkuptime, veçanërisht me komunitetet lokale, të cilat jetojnë në keto rajone me vlerat të larta.

Nga të dhënat e siguruar dhe puna e kryer nga të 5 OJF e përzgjedhura, vërehen mangësi të theksuara në funksionimin e tyre. Duhet pranuar që këto OJF nuk janë në standartet e kërkuar, ku ndër të tjera evidencohet mungesë e mjeteve të punës dhe të komunikimit, të mos pasjes së legjislacionit për fushën e ruajtjes së natyrës, të angazhimit të stafit dhe anëtarëve të tyre si dhe të mënyrës së bashkëveprimit me banorët, institucionet përgjegjëse, komunitetet e biznesit, etj.

Për këto organizata, medoemos, duhet të vijojë ndjeshëm procesi i ngritjes së kapaciteteve të tyre, të mbështetjet me logjistiken e nevojshme për promovimin e natyrës, të forcimit të rolit dhe të rritjes së bashkëveprimit konkret me komunitetet, palët e tjera të interesuar si dhe me strukturat shtetërore në nivel kombëtar e qendror dhe ato private, që kanë interesa për ruajtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Njëherazi duhet të trajnohen për zbatimin e platformës së investigimit, të ndërmarren iniciativa duke i përfshirë më mirë në monitorimin dhe advokimin e problematikave të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit, duke rritur presionin dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, nëpërmjet promovimit dhe sensibilizimit të banorëve, komuniteteve, shkollave, pse jo dhe të anëtarëve të këshillave bashkiake.

Sfidat në fushën e mbrojtjes së natyrës janë të shumta, por në këndvështrimin tonë më të rëndësishmet për t'u marrë në konsideratë janë: (i) Kontrolli mbi territorin dhe zbatueshmëria e ligjit, mbetet e rëndësishme, kryesisht në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore si pyjet, kullotat, fauna e egër dhe gjuetia, ujërat, peshkimi, bimët mjekësore dhe aromatike; peizazhi dhe planifikimi i integruar i territorit, ndotja e mjedisit, etj, (ii)

Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 4

Menaxhimi i integruar dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore që lidhet me institucionet vendore që kanë nën përgjegjësinë e tyre jo vetëm në politikat lokale të zhvillimit, por edhe administrimin e burimeve natyror. Në këtë kuadër një nga aktivitetet më të rëndësishme do të jetë monitorimi dhe advokimi për zbatimin e kuadrit legjislativ dhe rregullator për ruajtjen e natyrës, çka përbën sfidën më të rëndësishme dhe një perceptim për OMSHC. (iii) Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrje, nëpërmjet komunikimit, edukimit, ndërgjegjësimit publik dhe trajnimit, mbetet një sfidë e rëndësishme, pasi nuk mund të mbrohet

asnjë vlerë natyrore në rast se kjo nuk lidhet drejtpërdrejt me interesat e komuniteteve lokale. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuere e edukuese të synohet një pjesëmarrje më e gjerë dhe aktive e përfaqësuesve të komuniteteve lokale në forumet e ndryshme vendimmarrëse, lidhur me menaxhimin e burimeve natyrore, etj). (iv) Vullneti politik, duke parë faktikisht që ende natyra dhe biodiversiteti nuk janë prioritar, duhet edhe një vullnet i qartë politikë për ruajtjen e tyre, të peizazhit dhe të burimeve natyrore.

STOP Urbanizimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta

Koalicioni i Shoqërisë Civile në Mbrojtje të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta shpreh shqetësimin e lartë në lidhje me propozimin për ndërtimin e një kompleksi urban në zemër të Parkut Kombëtar dhe në shkatërrim të vlerave të tij, të Zonës Ramsar të Lagunës së Karavastasë, Zonës Emerald, Zonës së Rëndësishme për Shpendët, Epiqendrës së Larmisë Biologjike dhe Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë.

Urbanizimi i emërtuar si Master Plani “Resort Divjakë Albania” dhe i propozuar në formën e s o t m e p r a n ë autoriteteve shqiptare nga Kompania Mabetex Group nuk është asgjë tjetër veçse një projekt i ri ndërtimi në një Zonë të Mbrojtur që kërkon të përfitojë privatisht nga

një pasuri kombëtare e ruajtur prej shekujsh dhe sanksionuar në disa akte ligjore mbrojtëse që e kanë zanafillën që prej vitit 1964.

Projekti i ndërtimit kërkon zënien dhe zhdukjen e 10% të territorit të Parkut ndërkohë që infrastruktura shoqëruere e përbërë nga rrugë, ndriçim, rrjet elektrik, dallgëthyes dhe aktivitete të tjera do të ndikojë negativisht në 100% të sipërfaqes së tij. Për një vlerë vetëm 1 Euro, projekti kërkon të zaptojë 12 km të vijës bregdetare, të ndërtojë 2,400 apartamente, 370 vila, një resort turistik prej 90 ha dhe një qytet për 18,000 banorë. Ky kompleks i ri urban

është për nga popullsia sa dyfishi i qytetit të Divjakës ndërkohë që ka një shtrirje dhe ndikim shumë më të gjerë në territor.

Procedura e ndjekur deri më tani nga institucionet e shtetit dhe investitori për paraqitjen e projektit para publikut është e kundra ligjshme dhe përpiket të fshehë karakterin shkatërrues të këtij projekti që do të sjellë jo vetëm dëmtim të ekosistemit,

habitateve përbërës dhe gjallesave të egra por edhe shkatërrim të ekonomisë lokale e sidomos asaj të peshkimit.

Investitori i këtij projekti i kërkon qeverisë shqiptare të shkelë me të dy këmbët kuadrin ligjor duke lejuar ndërtim në Zonën Qendrore dhe Zonën e Përdorimit të

Qëndrueshëm të Parkut Kombëtar. Projekti është në kundërshti të plotë me legjislacionin shqiptar për Zonat e Mbrojtura, Konventën e Ramsarit, Konventën e Bernës, Konventën e ESPOOS dhe Direktivat e Habiteteve dhe të Shpendëve të Bashkimit Evropian. Miratimi i këtij projekti do të zhvlerësonte të gjitha nismat institucionale dhe ligjore të Qeverisë dhe Parlamentit për mbrojtjen e natyrës.

KY PROJEKT ËSHTË SHKATËRRIMTAR, I KUNDRALIGJSHËM DHE DUHET NDALUR!



Vijon nga faqe 5

Koalicioni i bën thirrje politikës shqiptare dhe ekzekutivit që të gjykojnë dhe të marrin vendime duke zbatuar paketën ligjore kombëtare për mbrojtjen e natyrës, mjedisit dhe zhvillimit lokal, si dhe marrëveshjet

ndërkombëtare të ratifikuara me këtë qëllim.

Shoqëria civile nuk do të tërhiqet nga lufta për mbrojtjen e së mirës publike nga ky shkatërrimi i parathënë.

OMSHC-të shqiptare për promovimin e mbrojtjes së natyrës

Përmet, 21 Prill 2017 - INCA në kuadër të projektit "Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMSHC) Shqiptare për promovimin e mbrojtjes së natyrës në Shqipëri", mbështetur prej programit ACHIEVE, organizoi në Përmet tryezën e rrumbullakët me përfaqësues të pushtetit vendor përgjegjës për menaxhimin e burimeve natyrore, AdRZM-Gjirokastrë, Organizata Mjedisore të Shoqërisë Civile lokale etj, për të ndarë rezultatet e investigimit dhe zbatimin në praktikë të legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri, me fokus Parkun Kombëtar "Bredhi i Hotovës". Kjo iniciativë është ndërrmarë nga OMSHC lokale dhe kombëtare. Procesi si fillim ka nisur me rritjen e kapaciteteve të organizatave përfaqësuese mbi legjislacionin ekzistues për ruajtjen e mjedisit dhe më pas puna është zhvendosur në terren me zhvillimin e monitorimve sporadike dhe intervistave në institucionet, puna e të cilave lidhet me menaxhimin e burimeve natyrore. Të dhënat janë grumbulluar dhe përpunuar në një vlerësim/raport i cili analizon performancën e legjislacionit

ekzistues për mbrojtjen e natyrës në Shqipëri, nga pikëvështrimi i OMSHC-ve.

Qëllimi i kësaj tavoline të rrumbullakët ishte ndarja e gjetjeve me OMSHC lokale pjesëmarrëse dhe njëkohësisht institucionet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore,



por edhe dhënia e një modeli për OMSHC lokale mbi rolin e tyre në vazhdimin e këtij procesi në të ardhmen.

Shkencëtarët e gjeneratës tjetër

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri ju bashkua fushatës së Ditës së Tokës, "Edukimi mbi Mjedisin dhe Klimën". Mendojmë se arsimimi është baza e përparimit, kështu që një e ardhme e shëndetshme e burimeve natyrore, mund të fillojë edhe nga edukimi i brezit të ri.

INCA në bashkëpunim me AdZM-Gjirokastrë organizoi në Parkun Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, një aktivitet edukimi mjedisor në natyrë, me nxënës të shkollës



9-vjeçare "Meleq

Gostinisihti" në Përmet.

Në të gjithë botën dhe sidomos në Shqipëri, dhënia e njohurive të nevojshme shkencore dhe mjedisore gjeneratës së re duhet parë me prioritet, për të hedhur baza të shëndosha për një vendimmarrje të përgjegjshme në të ardhmen, lidhur kjo edhe me përdorimin e burimeve natyrore.

"Shkencëtarët e gjeneratës tjetër" ishte tema e aktivitetit të zhvilluar në natyrë mbi

parimin e përqsjes së shkencës me

Vijon në faqe 7

Faqe 6

Vijon nga faqe 6 komunitetin. Në bazë të programeve të shkollës, fëmijët mësuan rreth zonës së mbrojtur, ekosistemit pyjor dhe karakteristikave të pemës, përdorimit të mjeteve të thjeshta shkencore etj. Fëmijët patën mundësi të marrin pjesë aktivisht në demonstrimin e monitorimeve të bëra nga



përfaqësuesit e administratës së parkut, të ngjashme me ato që ata bëjnë gjatë punës së tyre të përditshme. Ata monitoruan së bashku temperaturën dhe lagështinë e ajrit, koordinatat, drejtimin e erës, cilësinë dhe karakteristikat e ekosistemit, kafshët e egra, karakteristikat e pemëve (llogaritja e lartësisë, diametrit dhe moshës), proceset dhe ciklet biologjike etj. Gjatë aktivitetit u mbuluan në të njëjtën kohë njohuri nga disa lëndë si: biologjia, kimia, fizika dhe matematika. Në fund, fëmijëve ju kërkua të plotësojnë një letër të ngjashme pune me ato që plotësojnë rojet e parkut gjatë punës së tyre të përditshme.

Zhvillimi i një aktiviteti të tillë në natyrë është bërë për të inkurajuar nisma të tilla edhe në vazhdim, dhe njëkohësisht për të inkurajuar bashkëpunimin midis fëmijëve, për të dhënë një alternative tjetër mësimdhënie interesante, për të stimuluar imagjinatën e fëmijëve në çështjet abstrakte të shkencës etj. Këto aktivitete i mbajnë fëmijët të angazhuar me shëtitjet në natyrë, me njohjen e natyrës dhe mjedisit përreth, dhe njëkohësisht i largojnë nga përdorimi i intensiv i teknologjisë.

Megjithëse mësimdhënia në natyrë është një mjet shumë i efektiv për të edukuar mbi natyrën, në Shqipëri nuk është pranuar/praktikuar nga shumë shkolla ose administrata të parqeve (në rastin të parqeve). Administrata e Parkut duhet të ofrojë programe specifike për shkollat gjatë

javës ose familjeve gjatë fundjavës, ndërkohë që shkollat duhet t'i vendosim ato në kurrikulat shkollore. Përpara se ky proces mësimdhënie të përqafohet në mënyre masive, trajnime të stafëve specifike duhet të ofrohen pasi edukimi nëpërmjet interpretimit kërkon edhe aftësi të veçanta dhe nuk mund të praktikohet nga gjithkush.

Duke u rritur, shtohen shumë presionet mbi fëmijët. Gjatë formimit atyre ju duhet të qëndrojnë të ulur në klasë për disa orë dhe të japin përgjigje për çka kanë mësuar në klasë (në mënyrë interaktive ose jo), ndërsa të mësuarit më pranë pyllit, lagunave dhe vendeve bregdetare dhe veçanërisht pranë zonave të mbrojtura, u shton kureshtjen dhe nevojën për ti eksploruar në mënyrë të pavarur faktet dhe fenomene natyrore (hands on), për të cilat ata mësojnë në klasë gjatë formimit të tyre. Mësimi në natyrë i ndihmon fëmijët të angazhohen në zgjidhjen e problemeve reale, të zhvillojnë mendimin praktik rreth proceseve të ndryshme natyrore, të mendojnë globalisht, të jenë me kreative në zgjidhjen e problemeve dhe i ndihmon të zgjidhin sfidat mjedisore e sotme dhe të nesërme.

Mësimdhënia në natyrë është po aq e rëndësishme sa edhe mësimi në klasë. Mësimi në natyrë nuk është kurrë një ditë e humbur, kështuqë iniciativa të tilla duhet të inkurajohen në vazhdim.



INCA angazhohet se do të vazhdojë të përforcojë mesazhin e Ditës së Tokës gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm, duke vazhduar punën me edukimin mjedisor në natyrë, trajnimet mbi edukimin mjedisor, dhënien e eksperiencave më të mira etj.

Albanian NGO for the promotion of nature protection

Përmet, 21 April 2017 - A roundtable with representatives from the local government, RAPA-Gjirokastra, and Environmental Organizations was organized in Përmet in the framework of the project "Empowerment of Albanian Civil Society Organizations for the promotion of nature protection in Albania", financed by ACHIEVE program and implemented by INCA Albania. The roundtable aimed at sharing the results of the investigative report regarding the practical implementation of the legislation on the nature conservation in Albania, focusing mainly in the area of the National Park "Bredhi i Hotovës".

This initiative was undertaken by the local and national environmental CSOs. The process started by increasing organizational capacities on the existing legislation for environmental



preservation and then continued with sporadic monitoring activities in the ground and questionnaires addressed to institutions whose work relates to natural resource management. The data have been collected and processed in an assessment report that analyzes the performance of the existing nature protection legislation in Albania from the local environmental CSOs' point of view.

The purpose of this roundtable was to share the findings of the report with the participating local environmental CSOs and responsible institutions for managing the natural resources, as well as providing them with a model and guidance to continue this process in the future.

Scientist of the next generation

Institute for Nature Conservation in Albania joined the International Earth Day campaign on Environmental & Climate Literacy. Because we strongly advocate on education as the foundation for progress, education of youth today can be one of the first steps of healthy ecosystems in the future.

Hereby, in collaboration with the Regional Administration of Protected Areas in Gjirokastra, Institute for Nature Conservation in Albania organized in Bredhi i Hotoves - Dangëlli National Park on outdoor environmental education activity, with students of "Meleq Gostinishti" school in Permet.

All over the world and especially in Albania, empowering the next generation with necessary

scientific and environmental knowledge to make healthy decisions in the future and undertake responsible actions to sustain fragile natural resources and habitats, should be seen with great priority.

"Scientist of the next generation" was the

theme of the outdoor activity organized as a community science approach. Based on their school curricula children had to learn on the protected area, forest ecosystem and tree, use of simple scientific tools etc. Children had the opportunity to actively participate together with the park administration



representatives in simple wildlife monitoring activity; they had to monitor together air temperature, air humidity, coordinates, wind

direction, ecosystem quality and features, wildlife coverage, tree characteristics (height, diameter and age calculation) etc, similarly to the rangers everyday work. During the activity are covered in the same time different school subjects like: biology, chemistry, physics and mathematics. After all, children are asked to fill



out a working paper similar to the ones that park rangers have to complete during their everyday work.

This outdoor activity is designed to encourage similar initiatives in the future, development of classroom community, making learning funnier and hands on, and stimulating children's imagination on abstract natural science issues. These activities keep children engaged in hiking in nature, getting familiar with nature and surroundings, and the most important destructing them by the use of technology.

Although they are a very effective tool in learning, in Albania outdoor learning is not highly embraced by schools or park administrations (in case of parks). Park administrate should offer specific programs for schools or families, while schools should corporate them in school curriculums. Before this teaching technique is massively embraced, specific staff training needs to

be provided because education through interpretation requires special skills and cannot be practiced by anyone.

By growing, too much pressure is put on children. Eventually they are asked to sit in the classroom for some hours and provide answers on what teachers told them the day before, while outdoor learning in the forest, lagoons, and coastal sites gives them the great curiosity of exploring facts, figures and natural phenomena's on their own. Exercising outdoor learning during childhood, children are engage with a real world problem solving, practical thinking about natural science processes, think globally, solve problems creatively, and help them deal with the environmental challenges of today and tomorrow.

Outdoor teaching is as much important as classroom teaching. Outdoor teaching is not a wasted day of science, so similar initiatives should be encouraged in the future.

So, Institute for Nature Conservation in Albania, commits to follow fostering the International Earth Day message all year long and not only, by working on outdoor environmental education initiatives, training, providing assistance and sharing best example.



Shqipëria JO! DUHANIT

NJOFTIME

- 13 Maj - Dita Botërore e Shpendëve Migratorë
- 22 Maj - Dita e Ndërkombëtare e Biodiversitetit
- 23 Maj - Dita Botërore e Breshkave
- 24 Maj - Dita Europiane e Parqeve
- 31 Maj - Dita Botërore Kundër Duhanit

1- Klaus Toepfer Fellowship - Klaus Töpfer Programme. Promoting excellence and leadership among emerging nature conservation leaders from Central and Eastern Europe, the Caucasus and Central Asia.

<http://www.bfn.de/klaus-toepfer-fellowship.html>

2- Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



Organizatrat Partnerë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro